

BIBLIOTEKA
SHTETIT

PSH-1

C 18

ZEQIR
CAMA

**ESHKALLËT
LABËRISË**

POEZI

85H-1
CL8


ZEQIR
CAMA

SHKALLËT E LABËRISË



17659

POEZI



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

SHKALLËT E LABËRISË

Labëria shkallë-shkallë
me përrenj e gryka thurur
herë mbi malet kurrizdalë
herë mbi gjunjë rri e ulur.

Gur e dhé shkallët e tua
s'ka usta t'i bëjë kaq mirë,
vetvetiu janë gatuar
lidhur fortë si zinxhirë.

Kur t'u deshën i ke zënë
pas një prite pranë një shtegu
ndaj nga thembrat janë ngrënë
sa nga shpata nga dyfeku.

Gurë stralli janë gjysmuar
majëthike e majësheshtë,
shiu e bora i ka lëmuar
si shajakun tënd të leshtë.

Sot nga kazmat dhe lopatat
shkallët zihen valle-valle,
vetullkrehurat tarraca
varen malit si medalje.

AUTOBIOGRAFI

Nga fushë e luftës s'erdha vetëm
por triumfues me shokë të mirë
prapë mes shokëve, i ndershëm,
t'më ndajë e fundit lamtumirë.

Ç'plagë kam marrë mos më pyetni,
s'bën t'i shohim gjithnjë plagët,
hapi mbrapa po më mbeti
m'u thafshin që nga rrënja krahët.

Vërtet në luftë s'më ngeci arma
me dorë a këmbë të kalbëzuara
por s'do të thotë në vite mbrapa
t'më shtyjë ram-bam e kaluara.

Dhe s'do të thotë kurrësesi
të mos shkrijë forcat gjer në dhembje,
çdo gjë, në jetë, me ndershmëri
ta bëj me zell në punën time.

Jetë të pastërt pa zikzake,
s'dua tjetër gjë për vete,
me cingra-mingra dredharake
të mos përlyhem në ndërgjegje.

KËNGA E POPULLIT PËR MUSTAFA MATOHITIN

Vanë kohë që s'na ke dalë
dhe s'na hiqesh, kaq nga syri,
ç'tu tha kolla, t'u bë halë
komisar, o Muço trimi.

Zëri yt kumbon i ëmbël
degë më degë nëpër pyje
dhe në qiell si bilbil
të dëgjojnë një grusht yje.

Udhë pas udhe gjurma jote
u bë shkëmb e lëshon çika
të kaptojë balli i shokëve
sa herë bie keq në prita.

Gjaku yt lule më lule
pika-pika ra nga mali,
te çdo vatër që u ule
u bë dritë, o Muço djali...

TOKA DHE NËNA

Në jetë më prunë dhe më rritën të dyja,
në barkun e tyre shtrihen rrënjët e mia.

Toka më tha: «U bëfsh djalë për nënën!»
Nëna më tha: «Ruaje tokën në zemër!»

Nëna s'ma përflet sa qumësht më ka dhënë,
toka s'ma përflet sa vjeç më ka bërë.

Veç di një gjë: toka dhe nëna
ruajnë dhe mallkimin përbrenda.

Ai, që tokës dhe nënës s'ia di...
pikon në zemër katran e mavri.

Qumësht' i nënës e zë pas kokës,
në fyt e zë buk' e tokës.

Sadoqë të dimë dhe të rritemi në jetë
nënen dhe tokën kemi djep.

O KËNGË LABE...

Çdo këngë tjetër ç'mund të jetë
s'ia zë dot vendin isos sate
herë shtruar-shtruar pendë e lehtë
herë të pushton gjithë ç'ke në mendje.

Ndoca qejfli shumë shekuj shkuar
u mblodhën bashkë pranë e pranë
mbi pesë gjashtë zëra të bashkuar
u lidhën fort dhe nuk u ndanë.

Në rrugë dhe skenë ku të zë hera
shkrep si gjëmim nga mali
se s'je një cicërimë pranvere
po dallgë e fortë që djersin ballin.

Frynë stuhë e prapë u kthyen
s'mundën dot çfarë të të bënin
n'asnjë tingull s'të përlyen
dhe mbete këngë siç e do vendi.

LIBRI I SHTËPISË KU U THEMELUA PARTIA

Vizitorët çka patën në zemër të bukur
e lanë në këtë libër të thjeshtë,
nesër fëmijët tanë të lumtur
ta ndiejnë të tyre çdo rresht.

Stërnipërit në shekujt që vijnë
brezi-brezit do t'ia lënë patjetër
ta gdhendim librin më mirë
me gurët që mban kjo strehëz.

Ai që më dha telegramin
nxitoi e më tha dhe një emër:
«Të na rrojë vëllaçko, djali
se të gjithë u gëzuam me zemër!».

Në s'u bëftë dot artilier
ndoshta për çka tjetër është i prirë,
abdhetar i mirë po të jetë,
do të bëhet dhe snajper i mirë.

KUR TË PËRCOLLËM NË VARREZAT E DËSHMORËVE

— Për Cirok Camën —

Gjithë mbasditen, atë ditë, kishim një komb në
grykë.
Gjithë natën, atë natë, kishim një zog në zemër.
Në qoftë se na u rrokullis dhe një pikë loti nga
sytë
kjo sadopak na lehtësoi ca dhembjen.

Një dorë me baltë, një dorë me eshtra
shtrënguan në një kuti të kuqe gjithë rrugës,
të qe e mundur atë ditë do të bija vetë në varreza
të ngriheshe ti, trim dhe i bukur.

LETËR KUSHËRIRËS NË QYTET

S'kisha kohë të vija vetë
larg e larg na mori malli,
do t'ju vijmë dhe në qytet
dhe nga qejfi dhe nga halli.

Po më thanë, këtë behar
ke dërguar dy-tri letra
për dhjetë kile lesh të larë
nga shargani i dhënve shterpa.

Fije gjatë e fije butë
dhe të tjerur me lezet,
që ta bësh qilim me gusto
ta shtrosh rrallë mbi parket.

Natyrisht, ti ke ca shije
për qilim të ri me lule
po s'e di që fije-fije
mbetet leshi nëpër shkurre.

Dhe ta mbledhësh s'është lehtë
zdrëng-zdrëng pas dhënve malit
fryjnë erëra, shkunden retë
si meraket e çobanit.

Ti s'e di, moj kusho xhani,
se në fshat s'ke ardhur kurrë,
që të qethësh dhën maj'malit
duhet fjetur gurë mbi gurë.

Fije gjatë e fije butë
dhe të tjerur me lezet,
s'ke ku gjen në tjetër vend
veç në fshat, moj e shkretë.

Sa për ty, ma ka dhënë
një çoban nga fisi im,
ndonëse të ka ardhur rëndë
kur të shkeli mbi qilim.

KOHË LUFTE

Gulçonin përrenjtë me ujëra të turbullta,
një natë prej netve,
kasolleve u tundeshin këmbët e drunjta,
një natë prej netve.
Ca larg nga fshati, në një grykë të vetme,
një natë prej netve,
korrieri çetës ra në përpjekje,
një natë prej netve.
Qe mezi shëndreut dhe bora kish zënë
tri bora nën vete.
Ulërinte era sikur priste një gjëmë,
një natë prej netve,
të çaje rrethimin kishte vetëm një shteg
një natë prej netve,
ai qe një, fricët dhjetë
një natë prej netve.
Ç't'u bënte atyre Hete partizani,
ç't'u bënte kështu?

Një plumb dum-dum e skuqi te balli,
një tjetër në gju
e prapë luftoi më shumë se herë tjetër,
një natë prej netve.

O, më tej, ç'mund të bënte më tepër
partizani Hete?!

— Ç'të bëj së fundi, tha Hete partizani,
me një bombë të vetme?

Në brez i zbrazur i varej gjerdani
si zemër me derte.

Kërkoi fishekë po ku t'i kish, vallë?

Një natë prej netve,


Të paktën të kishe tani dhe një ballë,
more Hete...

Të çaje rrethimin nga rruga e verbër
me shkoza dhe mbrete,

ç'të thuash më parë për përpjekjen e egër,
një natë prej netve.

Luftoi me dhjetë, me nëntë e me tetë
partizani Hete,

s'iu ndodh as bukë as ujë dhe as fishekë,
një natë prej netve...



11659

PËR CA DJEM

S'ju shohim dot duke zënë prita
të ndalni vajzat pa i njohur,
nëpër stacione e rrugica
premtoni dashuri «të modës».

Dhe flisni si për ndeshje sporti
për vajzat tona shumë të ndershme,
vini bast e rrihni gjoksin:
— Për një javë e bëjmë për vete!...

S'ju shohim dot pranë kinemasë
me një biletë rezervë në xhep,
duke përgjuar ndonjë vajzë
t'i thoni: — Mos kërkon biletë?...

S'ju shohim dot mbi biçikleta
si gjela deti për në treg,
në vend të fjalës «tungjatjeta»
na thoni: — Ç'gjah u del në shteg?

S'ju shohim dot, s'ju shohim dot
në bar-lulishte a në parqe.
tek vrisni mendjen, kot më kot,
për dashurira me citate.

ELEGJI PËR PUNËTORIN E VJETËR TË KAMINËS

Tundnin degët lisat në lajthishte
me rrëshirë trungjet pishat lanin,
me ca ligjërime labërishte
te kamina gratë zunë e qanin.
Duke ndrequr gurët mbi kaminë,
e pamë për herë të fundit xha Rasimin.

Ai kishte djegur shumë kamina
vetë i kish bërë, e i kish kthyer.
Krahët gjer në supe i qenë pjekur,
djersa pika-pika i qe zier
dhe pse pranë na rrinte gjithnjë
kurrë nuk u ç'mallëm me të.

Kishte kohë që ngjitej mbi gjashtëdhjetat
dhe që bërë mjeshtër i kaminit,
mund të që, në qoshet më të qeta
qëkur mori librezë invalidi,
se këmbën bombat ia kishin prerë
kur iu fut nazistit në bunker.

Sa herë që e mori shkaraz plumbi
dhe sa herë që fshinte ndonjë plagë
u krenojshokëve xha Rasimi:
«Kam shpëtuar mirë dhe këtë radhë!»
Dhe më pas i urti xha Rasim
i ka tharë plagët mbi kamina.

Unë e pashë nga afër xha Rasimin
kur mbështeti kokën pranë një guri
dhe kërciste zjarri te kamini
për t'i ngrohur gazin atij burri.
Zemërmiri, mjeshtër i moshuar;
kaq me mall na iku nga duart.

.....

Duke ndrequr gurët mbi kaminë,
e pamë për herë të fundit xha Rasimnë.

NË PRAG TË ÇLIRIMIT

Hallakatur tutje-tëhu nëpër rrugë e në sheshe
tymi i luftës përkundej si miell i situr
ndërsa në sofatet e vilave borgjeze
rrokullisej kapitali nëpër lotët e kripur.

Zbatharakët e varfër brohorisnin rrugëve:
— U çlirua qyteti, u çlirua qyteti
dhe prapë i strukur në qelira bodrumesh
shpresonte, buzë varrit, borgjezi.

Tej rrugëve me tymn e mureve të shembur
zjarret partizane flak bubullinin.
Kjo qe për t'përmbysurit fundi i tyre i dhembur
njëkohësisht për ne feks' e shtetit që ngrinim.

KOMANDANTI KARAFIL BELLO

Si e shtriu plumbi, thonë atë...
Ç'djall-o plumb na qe ky kaq i hidhur?!
Mbi katër-pesë prita zunë për të
mbi katër-pesë plagë kishte lidhur.
Kush e njohu afër trimërinë,
njohu bashkë me të dhe Karafilnë.

Mbi një djep të rraphtë i thanë ninulla,
mbi një postë leshi ai u rrit,
në këngë mbante iso për pesë burra,
sa për pesë-gjashtë trima qe në pritë.
Në çdo pritë e sulm do t'ish në ballë,
komandant i mirë e shokë i rrallë.

Sa i zgjuar dhe kokëkrisur ishte,
plumbit një pëllëmbë si shtyhej tutje;
atë shpesh e zhduknin brenda dite
nëpër pesë a gjashtë qelira burgjesh,
mund ta nisnin dhe në Romë a Vjenë
por asnjë majë thoi dot s'i blenë.

Një sy dielli nuk e pa i çlodhur,
një copë bukë s'hëngri kurrë me ëndje,
si një lëng që shtrydh lule shtogu
zemra i kullonte një det dhembje.
Kush e kish për luftën shpirtin gurrë,
bukë pak po plumba hëngri shumë.

Tej në prita ku sulmonte çeta,
tej në Cepo ku gjëmonte briri,
ku hanim dhjetë shokë në dy gaveta
në mes trimash shquhej Karafili.
Sot shokët për të thonë me mall:
«S'e shtrinte dot plumbi ballë për ballë!»

Karafili kish vështrim gaztori
me dy sy të feksur si ujë lugjesh,
kur një plumb i ngjeshi kraharorin,

i ranë përmbi ballë dy copa muzgjesh.
O, kështu s'e kish ndier veten kurrë
ndaj thirri: «Mbaje veten, burrë!»

Te një rrjep e kuqe mbi Olena
ku shkërmoqesh gruri si thërrime
prapë së dyti thirri: «Para, djema!»
dhe s'e ndiente fare se do ikte.
Një plumb tjetër mori, s'di se ku...
Ndiqte prapë luftimet dhe kështu...

Afër ca degë shqopesh thyen krahët
dhe i shkundën lulet zemërtrishtë,
tek përgjonin zemërngrire zuzarët
e goditën trimin befasisht.
Kur s'dëgjuan të fliste ndonjë fjalë
britëm bij e etër: «Karafil, o djalë!»

FLUTURIMI I PARË

«Sa qiell që ka, sa qiell që ka,
sa shumë jemi ngritur nga toka!»
Për herë të parë fluturojnë ata
në të ajrit rryma të forta.

Hapësira të gjera në vështrimin e tyre
përthyhen dhe priten përgjysmë,
në qoftë se do t'u dridhen kapakët e syve
s'do të bëhen aviator të fuqishëm.

Ata duan t'i këpusin dhe zemrës një copë
t'na i hedhin nga lart si yll,
domosdo do të bëhen aviator të zotë
derisa janë ushtarë të mirë.

BARDHËSI

Aviatorit Bego Hoxha, që ra në krye të
detyrës.

Sa herë për ty kam nisë të shkruaj,
s'ta shpura shkrimin gjer në fund,
si ç'le ti gjysmë rininë tënde
pa e mbështetur mbi bastun.

Mbi krah të erës mate vrapin,
O, vrapi yt gjëmon nga lart,
shtyhen retë dhe rrugën hapin
në lartësi a në pikjatë.

Ti futesh, ngrihesh fluturimthi
pranë detyrës,
qiellit,

tokës.

Larg e afër pranë të gjithëve,
brenda një bisede shokësh.

Por xhami i kaltërt sipër reve
u ça mes zhurmash metalike
dhe nxiu pist' e gjatë në heshtje
dhe mbetën shokët
poshtë në pritje.

Zogjtë që shtegtojnë tutje
kthehen prapa përsëri,
tek zgjatet qiellit
udha jote
si shteg i bardhë në kaltërsi.

ME SHËRBIM NË KUFI

Pashë këtej më tepër heroikë,
si në çdo pikë tjetër kufitare,
këtu nata të shketë mbi qerpikë
dredha-dredha në çdo çast tinzare.

Shtatë ditë e netë renda klonit
tjetër fëshfërimë lëpin barin,
këtu duhet tepër shkathtësi
në çdo brez që ruan kufitari.

Gjithë natën këtej mund të ndjesh
në ç'gjumë të lehtë dremit toka,
këtu ka shumë intuitë
dhe s'ka histori e anekdota.

Tjetër zemërim këtej ka era,
era fluturake krahëgjelbër,
këtu e pagjumshmia vigjilencë
vë përpara shkelësit dhe në ëndërr.

LUFTA E NJË SPITALI PARTIZAN

S'kishte salla operimi,
as barna shumë për të kuruar,
nëntë shtretër ngjitur rrinin
dhe gjashtë shokë të rrethuar.

Jashtë pritat qenë të zëna
prapa mureve gjer te pragu,
gjurulldi dhe çjerrje zërash
ogurzes dhe të përgjakur.

Kërkëllinin dyert, trarët,
breshëri dhe krişma pushke,
morën plagë të gjashtë tanët,
gjashtë ekspozita lufte.

Bënë ç'mundën sa nuk patën...
të dorëzoheshin, kurrsesi!
Vunë zjarr dhe të gjashtë tanët
zunë pritë te kjo pusi.

PEISAZH MBRËMJEJE NGA FUSHËBARDHA

Nëpër shelgje varet hëna
sërë-sërë si hoje mjalti,
llamburit' e ndizet mbrëmja
sikur nata nis së prapthi.

Kur fryn juga mbi të gjitha
të flladit e të thanë djersën,
uji derdhet në korita
si ilaç që të zgjat jetën.

Tutje zgjaten galeritë
si ca tyta kundërajrore,
te një shesh lëpihen dhinë
në njëqind e ca kripore.

Larg çobenjtë ndezin zjarre,
vjesht' e parë e djegin barin,
ndërsa një qejfli i marrë
me dy zëra qan longarin.

Shoh i lumtur ç'më zë syri,
rreth e rreth s'më hiqen sytë
gruri i pjekur ngjyrë floriri
i kalon gjithë bukuritë.

TË DYMBËDHJETËVE

(Dëshmorëve të Fushëbardhës)

Ju s'dini ç'të reja kemi nga fshati
as plagët që mori s'arritët t'ia lidhni.
Po të vini këtu, tani, dhe një çast
patjetër do të harroni të ikni.

Duam kohë ta ç'mallim njëri-tjetrin
sidoqë ta nisim kuvendimin me ju.
Tridhjetë e ca vjet që na flisni në heshtje
u mbeti vështrimi këtu.

Nipërit e mbesat që s'arritët t'i njihni
shembëllimi juaj janë rritur,
kjo do të thotë që në vazhdimin e jetës
jeni gjaku ynë i rilindur.

MONOLOGU I EGOISTIT

Hej, hej!

Unë jam bërë akull,
akull,

akull

me shokët, me farefisën,
me miqtë.
Me gotën e egoizmit të mbushur
kam dehur vetveten, natyrisht.

S'më gëzon asgjë,
as pranvera me lule dhe qengja.
Në shtratin mono të moskokëçarjes,
për raki të fortë më qan zemra.

Dikush më quan gjaknxehtë
pse grindem me prindërit, me gruan,
ata duan telashe në jetë
unë telashet e jetës s'i dua.

Ç'kërkoni më shumë, u them,
s'mbarohen problemet e shtetit,
më shumë nga çdo gjë më pëlqen
pasqyr' e rreme e indiferentit.

Mbështetur mbi jastëqet e butë
vështroj televizorin i qetë,
le të lagen kooperativistët në fushë
le të mbarohet zaireja për qetë.

Bukën e marr në furrë
të bardhë, me miell të mirë,
le të mbeten duajt me grurë
në lëmë dy muaj pa u shirë.

Për vete asgjë s'më shqetëson,
s'më prekin as divorce bashkëshortësh,
turnin mbaroj pa u lodhë
në shtëpi i hedh llozin portës.

Dhe pi limonadën e ftohtë
(ndaj është frigoriferi)
ç'më duhen andralla në kokë,
këmbët m'i ngroh kaloriferi.
S'më prekin as zënkat e fqinjve,
le të zihen sa të çajnë çatinë,
domosdo, revoltohem prej tyre
vetëm se më prishin qetësinë!

USHTARËT E BATERISË SHËMBULLORE

Në fletë shinjestre shtrojnë synë
pas kalkulimesh të sigurta
t'i kesh të gjithë ushtar të tillë
do derdhësh shumë pak gjak në luftëra.

Stërviten shumë dhe topi i rëndë
u bindet, për në ballë të frontit;
sikur e kanë dorë e këmbë
çdo mekanizmë e pjesë të topit.

MOTIV ME ELEGJI TË HERSHME

Pemët zunë e shkundin fletët,
vjeshta erdhi para kohe.
Ku je ti në këto net,
ku je ti që nuk kujtohe!?

Përmbi varr hodhi kazmanë
shkula bar e hoqa dhé,
gjak e lot shpirti më qan,
si duron e ç'zemër ke?

Ranë shira dy-tre vjet;
bënë dimra kaq sa s'thuhet.
Ku je ti në këto net,
nga çfarë llafesh do të ruhesh?

Dil, moj dil tek çelin lulet
t'mos të vyshket vajzëria,
edhe hëna po të ulet
s'ta merr dot nga bukuria.

GRATË E ÇETËS VULLNETARE

— *Fjala e tyre në stërviçje* —

Në mbetën dhomat pa u larë
s'do t'na përbuzin si amvise,
në mbeti drithi arë më arë
do shkojnë vjehrrat edhe gjyshet.

Në mbetën burrat pa na parë
u thoni: — Na ka marrë malli,
megjithatë në vijë të parë
hidhemi mbi gryka zjarri.

Po syri i pushkës t'mos na luaj,
se vjen armiku drejt e brenda,
që burrat ne më shumë t'i duam
dhe ne më shumë t'na duan nënat.

* * *

Këtu te kjo kodër, këtu
pesë shokë na u ndanë nga çeta,
ishte dimër dhe bora mbi gju
na futi të ftohtit në eshtra.

Një natë pa yje, pa hënë
pesë shokët në duar i gdhimë,
pumbi njërin në ballë e kish zënë
të tjerët në krah e në brinjë.

O — natë, e papërsëritura natë!
Me flakën e hakmarrjes së çetës
ndeze dëborën me gjak,
bajoneta pret bajonetën.

Pastaj i mbuluam pesë shokët
të lodhur,

të heshtur,

në këmbë.

U mblodhëm të gjithë kokë më kokë
dhe shtërnuam dhëmbjen me dhëmbë.

* * *

TOPI I MBETUR NË CEPO.

Ai e nisi luftën hidhur
tek një breg mbi udhë të verbër
sa e prunë nga Italia
frap, e zunë
pesë-gjashtë lebër.

Kaq i ri,
i rëndë,
i vyer
grykëakull djegur vape,
zgjatet ulur shtratmbërthyer,
qafëgjatë, si qafë xhirafe.

Sipër grykash ngjyrë muzgu
rrotullohet gojë hapur,
çirret,
dridhet
pas një trungu,
pas çdo krisme i përgjakur.

Ulërin e digjet tutje
një autobлиндë italiane,
ndërsa topi

ngrihet,

ulet

larg te baza partizane.

VALLJA E GËRMAVE

— Nexhip Çarçanit, që u kthye nga Stambolli dhe më 25 nëntor 1907 hapi shkollën shqipe në Fushëbardhë të Gjirokastrës.

Të mbeti zëri pranë një honi,
zemërdjegur lavë e furrë,
ç'shpresë të pruri nga Stambolli
të gdhendje germat gur më gur?

T'u dhimb fshati, lum e halle,
konaklidhurit me furka,
ndaj fshehtë dy abetare
nën një xhybe allaturka.

S'prure mall' e plaqkë të rrallë
po ca këngë e histori
dhe çdo vatër në Fushëbardhë
të tha: «Bujrum, kurbetli!»

Shtruar vënçe, o burr i ditur,
ndonjë gunë a një post dhie.
O, sa shumë të kishim pritur
dhe pse s'dinim se do vije.

Shkriu bora, mbiu bari,
zogjtë çukitën këngë më këngë
buzë një honi të Fushëbardhës
ABC-ja hodhi rrënjë.

Rrezelara gjak e plumba
dritë nga drit' e shqipes sonë,
ngjeu fshatin sa s'e shkundën
as rrebeshët me ciklonë.

Gjuhë e ëmbël mjaltë nga mjalti
syrgjynosur nga sulltanët
mbrapa dyerve bëri gati
millëhequr, jataganët.

Ç'brenjë të mbeti e pashuar
larg nga dufet orientale,
dymbëdhjetë burra festshkruar
në dorë morën abetaren.

Lugjesh, shpellash aq magjike
si kështjellat madhështore,
nisën vallen gërmat shqipe
gur mbi gur e dorë për dore.

Ti e dije, djall kuranit
korbat do t'i vinin mbi vete,
siç i pinin sytë nizamit,
kur «allahu» kishte etje.

Dhe do binin turbulluar
mbarë e prapë gërmat turçe,
si ushtri e dezertuar
në kazermë a në front lufte.

Po s'të shkonte kurrë në mendje
abetarja fletë-fletë
si relik pranë zemrës sate
të rrinte hapur për poetë.

S'të vente mendja kurrsesi
qëndisur mbi dy hejbe
të uleshe shtruar, xha Nexhip,
me gërmat shqipe në muze.

KURBETLINJTË

Buzë udhëve re të zeza
varur si jelet e kalit,
ç'janë ata që nisen natën
ku t'i shpjerë yll i karvanit!

Gjysmë zemre morën tutje
gjysmë zemre lanë prapa
thanë: — Ta keni dhe për luftëra
dhe për vdekje dhe për dasma.

Njërën dritë nga drit' e syve
mbajeni — thanë, — na e do zemra
të vështrojmë që tej kufijve
nuset, që s'i bëjnë dot nëna.

Njërën dorë për jetë të jetëve
mbajeni grusht nga krahu jonë
të thërrojmë që përtej deteve
një dorë baltë të tokës sonë.

DRITË NË NDËRGJEGJE

Kam kurajo t'ua them gjithë njerëzve të mi,
gjithë njerëzve të mirë, të panjohurve dhe shokëve
dy herë kolektivi për mua bëri mbledhje,
dy herë organizata për mua mblodhi shokët
më vërtitën e më kthyen 90° në ndërgjegje
dhe prapë më dhanë dorën e s'më lëshuan për tokë.

Më dukej vetja mbi ta gjithçka,
më dukej vetja talent i pa arrirë.
Më thanë shokët njëherë — më i thjeshtë vëlla,
më thanë shokët dy herë — kështu se ke mirë!

Por unë përsëri vështrova rrugën time
isha bërë intelektual i kënaqur me veten
gjersa organizata në një mbledhje të jashtëzakonshme
më kontrollloi dhe ma gjeti me njolla ndërgjegjen.

Dhe u ngritën një nga një e më vështruan në sy
më goditën komunistçe e më thanë dhe një herë
në qoftë se dhe tani s'do të bëhesh njeri
s'ke për t'u bërë njeri asnjëherë.

Dhe qysh nga ajo ditë u ndjeva i shqetësuar,
dhe qysh nga ajo darkë u përpëlita në shtrat,
gjersa në oborrin e ndërgjegjes sime të errësuar
një dritare e gjerë me diell m'u hap.

VRASJA E PARTIZANIT SULO ÇELA

Qe pranvera e parë dhe toka tirtë avull
pas një shiu të madh blerimi shkundte flokët...
Ai ra mbërthyer në shpatull
me fytyrë të gjakosur nga shokët.

Brinjas mbi vështrimin e zbetë
gjeti një çast të volitshëm
nga çanta dy krehër fishekësh
i ndau me shokun përgjysmë.

U tërhoq po s'mundi të shtinte
më dy plagë si krahët e pëllumbit,
kur ne ulëm vetullat me dhembje,
i lamë lamtumirën e fundit.

F I G A L I A

Atje ku bëhet valanidhi
u rrit e imtë pesëmbëdhjetë pranvera,
gërshetë të gjatë mbi supe lidhi
si degë ulliri nga rivjera.

Tha — të mblidhte portokalle
tha — t'i bënte punë nënës
por një natë u nis në male
sapo doli syri i hënës.

Kush s'i tha i mallëngjyer
tek kaptoi si veri:
— Ku je nisë, t'u bëftë diell,
Figali, o Figali.

Ecë e ecë e s'di të ndalet
lodhur, zbathur e pangrënë
me brigadën tundi malet
krahëshpata, zemërkëngë.

P O S T I E R I

Lajme sjell çdo ditë nga qendra
buzë netëve të vona
me një çantë nga PTT-ja
hynë e del në zemrat tona.

Mundet që ndonjë dritëshkurtër
ia ka fyer punën, djersën
se paska «zanat» pa gusto,
pa mendim të ri për jetën.

Le të dalë, ta shohë rrugës,
sa të zbardhë le ta presë
kush i thotë i pari punës
të parën fjalë «Mirmëngjes.»

Kush i pari thotë me dhembje:
— Marrim pjesë në dhembjen tuaj!
Kush të thotë: — Për gëzime,
kështu qofshi të gëzuar!

Ja, postieri vjen e ikën,
këmbëvëni mbi merak,
brenda në një çantë ka lidhë
zemrat tona pranë dhe larg.

DIALOGU I NJË NATE DIMRI

Ç'më kanë sytë që tretin lotë
ujërat turbulluar janë,
ku je nisur pa një shok,
trim, o partizan?

Nat' e zezë të ka lodhur,
lodhen trimat vallë?
Djalin tim a e ke njohur,
ka një këmbë të çalë?

Ndoshta ju s'e keni pyetur
dhe ai nuk ju ka thënë,
në tre burgje i ka mbetur
copa-copa ajo këmbë.

— Tej në prita natën vonë
ku dredhonte rrugën plumbi
djalin tuaj, shokun tonë,
mbrëmë e pamë për herë të fundit.

Mbylli sytë e la dy fjalë:
«Sulm, o shok, përpara!
Nëna lajmin kur ta marrë
thoni si u vrava.»

— Helmi, bir, sado i hidhur
dhembjen ka të keqe
dhe të ruhesh do të gjejë
mbyllur dhe në qelqe.

Po ka helm, e helm të rëndë
që pikon katran të zi,
sa as dheu nuk të tretë
kur je vrarë për tradhti.

Ndaj shokëve folu shtruar
nëna është vajzë mali
do të vij në çetën tuaj
se ju kam si djali.

Shpjeru dhe këtë bukë misri,
në vatër është pjekë,
fshehur në strehë për çetën
katër ballë fishekë.

NË ISHULL

Te ky ishull i vogël, i largët,
si shkëmb në mjegullnajën e detit,
sa herë që përplasemi me dallgët
aq herë shqetësohemi për njerëzit.

Anijet që vijnë nga rruga
si breg s'na duken nga larg,
gjithë kohën me këmbët nën ujëra
dhe prapë, themi; — Sa pak!

Dashurinë e njerëzve të kemi
s'na duhet as famë as titull
po mbetëm nën dallgët e detit
si rrënjët e tokës në ishull.

BALADA E NIZAMIT

— Sipas dy motiveve popullore

Ai mbeti përtej deteve,
dru që kalbet larg çdo druri,
lot e dhembje nëpër derte
fshehën katër faqe muri.

Një konak me katër trarë
i la nuse Selimesë,
mbi një kal balash të çalë
brodhi fushat e Moresë.

Ai tha se mund të vinte,
mbas tre a katër vjetëve
ajo thahej në çdo pritje,
dyll e verdhë si hëna netëve.

Me një furkë tirtë dhembjen,
vjehrr' e urtë i mblidhte gjalmin,
vjehrr' e nuse në pesë shtiza
bënin jelek për nizamin.

Zjarrin kurrë nuk e shuan
mbanin ndezur dhe qirinjtë,
ndoshta, nga udh' e largët
binin lajme qiraxhinjtë.

S'kishin det, as brigje afër
dhe nuk dinin ç'bëhej tutje...
Vetëm në dy pëllëmbë vatër
shtrydhnin dhembjen, vjehërr e nuse.

Prit e s'vjen nizam i shkretë
thonë: — Ku s'futet syri i hënës,
thellë, të ndonjë gryk e fshehtë
vinin shpezët mishëngrënës.

Thonë: — E panë për herë të fundit
(Vringëllinin shpatat egër)
thik' e ndryshkur e zabitit
i ra nëntë herë në mjekër.

Nëntë vdekje me sy mori
larg Atdheut zemër djegur
dhe s'e pa më i gjori
as i gjallë e as i vdekur.

Se e vunë në një vrap kuajsh
lidhur për një bisht kali
kishte etje balt' e huaj,
në çdo udhë, për gjak nizami.

PASQYRA E LËNDËS

Shkallët e labërisë	3
Autobiografi	5
Kënga e popullit për Mustafa Matohitin	7
Toka dhe nëna	8
O këngë labe... ..	9
Libri i shtëpisë ku u themelua Partia	10
Një ushtar më shumë	11
Kur të përcollëm në varrezat e dëshmorëve	13
Letër kushërirës në qytet	14
Kohë lufte	16
Për ca djem	18
Elegji për punëtorin e vjetër të Kaminës	20
Në prag të çlirimit	22
Komandanti Karafil Bello	23
Fluturimi i parë	26
Bardhësi	27
Me shërbim në kufi	29
Lufta e një spitali partizan	30
Peisazh mbrëmjeje nga Fushëbardha	31
Të dymbëdhjetëve	33

Monologu i egoistit	34
Dy heroina	37
Ushtarët e baterisë shembullore	38
Motiv me elegji të hershme	39
Gratë e çetës vullnetare	40
Këtu te kjo kodër, këtu	41
Topi i mbetur në Cepo	43
Vallja e gërmave	45
Kurbetlinjtë	48
Dritë në ndërgjegje	49
Vrasja e partizanit Sulo Çela	51
Figalia	52
Postieri	53
Dialog i një nate dimri	55
Në ishull	58
Balada e Nizamit	59